

5. Shkalla e pH

Masni pH e tretësirave të ndryshme si kafe, pështymë dhe sapun për të përcaktuar se cila prej tyre është acide, bazike apo neutrale. Vizualizoni numrin relativ të jonit hidroxide dhe hidronium në tretësirë. Kaloni vlerat në shkallë logaritmike dhe lineare. Vëzhgoni se ndryshimet në volum ose hollimi i tretësirave me ujë ndikon në vlerat e pH.

Shembull

- Përcaktoni nëse një tretësirë është acide ose basike.
- Vendosni përqendrimin e acideve ose bazave sipas një rendi të caktuar rritës apo zbritës.
- Përshkruani me ilustrim në shkallë molekulare si varion ekuilibri i disocijimit të ujit me ndryshimin e pH.
- Përcaktoni përqendrimin e joneve hidroxide, hidronium dhe ujë në një vlerë të caktuar të pH.
- Tregoni lidhjen e ngjyrës së lëngut nga pH.
- Përcaktoni (në mënyrë sasiore apo cilësore) se si hollimi dhe volumi ndikojnë në vlerën e pH dhe përqendrimin e joneve hidroxide, hidronium dhe të ujit.